

Dr. Hajredin Hoxha



VERSETET KURANORE PËRKITAZI ME PAQEN DHE LUFTËN

Assoc.prof.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**VERSETET KUR'ANORE PËRKITAZI ME PAQEN
DHE LUFTËN**

- *krahasim ndërmjet komentimeve klasike dhe bashkëkohore të Kur'anit -*

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Doc.Dr.Hfq. Hajredin HOXHA

Lexim në disa tefsire:

**VERSETET KUR'ANORE PËRKITAZI ME PAQEN
DHE LUFTËN**

- krahasim ndërmjet komentimeve klasike dhe
bashkëkohore -

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jo fitimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmimin e kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake me shkrim të autorit.

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:
Sedat ISLAMI

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Titulli në origjinal:

Dr. Hajruddin Huxheh,
*Ajatu-s-silmi ve-l-harbi bejne-l-mufessirine-l-kudama ve-l-muasirine,
kiraetun fi ba'di kutubi-t-tefsir,*

Dr. Hajredin HOXHA

Lexim në disa tefsire:

**VERSETET KUR'ANORE PËRKITAZI ME PAQEN
DHE LUFTËN**

-krahasim ndërmjet komentimeve klasike dhe
bashkëkohore të kur'anit-

Përbajtja:

Hyrje

Kapitulli I: KOMENTUESIT KLASIKË DHE VIZIONI I TYRE PËR LUFTËN DHE PAQEN ME ARMIQTË

1. Mendimi i Imam Taberiuut
2. Mendimi i Fahrudin Raziut
3. Mendimi i Imam Kurtubiut

Kapitulli II: KOMENTUESIT BASHKËKOHORË DHE VIZIONI I TYRE PËR PËRGATITJEN USHTARAKE DHE MARRËVESHJEN - ARMËPUSHIMIN ME ARMIKUN

1. Mendimi i Ebu Bekir Xhezairiut
2. Mendimi i Sejjid Tantavit
3. Mendimi i Sejjid Kutbit

Përfundimi

Hyrje

Falënderimet janë për Allahun e Madhëruar, ndërsa përshëndetjet më të sinqerta për të Dërguarin e Tij, Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*], familjen, shokët dhe të gjithë pasuesit e tij!

Ky punim, në fakt, është një referim shkencor për Seminarin e organizuar nga Fakulteti i Usuluddinit ne Brunei; tematika e të cilit ka të bëjë me kontributin e disa komentuesve klasikë dhe bashkëkohorë të Kur'anit, përkitazi me domethëniet dhe botëkuptimet e ajeteve kur'anore që shtjellojnë paqen dhe luftën. Kohët e fundit, në ligjërimet politike por dhe ato fetare, po diskutohet shumë rreth paqes botërore dhe qëndrimit islam karshi saj. Apo, thënë më mirë, debatohet për atë nëse Islami është fe e paqes apo e luftës, fe e tolerancës apo e dhunës, fe e xhihadit apo e pajtimit (ndërmjet popujve)... Për çudinë tonë, shumica e këtyre që diskutojnë rreth paqes dhe këndvështrimit islam për të janë njerëzit që më së shumti e luftojnë atë. Po kështu, trajtesave “shkencore” për paqen nga perspektiva islame iu mungon origjinaliteti dhe mbështetja kur'anore dhe pejgamberike.

Krahas kësaj, nuk më ka rënë të gjej ndonjë punim që i është kushtuar kontributit të shkollarëve muslimanë, të vjetër dhe të rinj, përkitazi me këtë çështje jo pak të rëndësishme, gjë të cilën, me lejen e Allahut të Madhëruar dhe ndihmën e Tij, dua ta sjell në këtë punim. Në fakt, qëllimi im është që, jo vetëm të zbërthej mendimet e tyre për këtë temë, por dhe të dëshmoj se sa shumë i kanë trajtuar temat fetare, shoqërore dhe ideologjike. Kësisoj, do të ishte e pandershme për një musliman të matur që t'i akuzojë dijetarët klasikë për mungesë trajtimi të problemeve bashkëkohore (por që rrënjet e tyre, të paktën teorikisht, shtrihen edhe në të kaluarën) me të cilat ne ballafaqohemi për kinse marrje me probleme të kohës së tyre. Ky punim provon se shkollarët muslimanë, gjatë shpjegimit të ajeteve kur'anore, ishin të vëmendshëm për domethëniet shumëdimensionale të ajeteve kur'anore, e që përfshijnë dimensione shoqërore, morale-edukative dhe fetare. Ky vizion për të ardhmen dhe kjo largpamësi i detyrohet sinqeritetit të tyre në raport me Kur'anin, sikurse që janë një mësim i madh përkitazi me atë se ummeti islam, ilaçin e

problemeve të vështira, me të cilat po ballafaqohet tanj, e ka pikërisht në Kur'an, në këtë libër të përsosur hyjnor, i cili vlen për çdo kohë dhe vend.

Një fakt tjetër që nuk bën ta neglizhojmë është se tekstet kur'anore dhe pejgamberike janë të kufizuara, ndërsa problemet dhe sfidat janë të shumta dhe realisht të pakufizuara, andaj, bazuar në këtë, kontributi i dijetarëve muslimanë përkitazi me problemet shoqërore, politike dhe morale është i përkufizuar në konceptimet dhe përpjekjet e tyre individuale në të kuptuarit e tyre (problemeve) nga Kur'ani dhe Sunneti. E lusim Allahu e Madhëruar t'i ketë shpërblyer të gjithë shkollarët tanë, që tashmë kanë kaluar në amshim, ndërsa të rinjtë t'i pajisë me vullnet, forcë dhe energji për të kontribuar sa më shumë!

Punimin e kam ndarë në kapituj kryesorë, ndërsa lëndën e kam shtjelluar në nënkapituj përkatës, respektivisht kam trajtuar qëndrimet klasike në kapitullin e parë dhe qëndrimet bashkëkohore në të dytin, duke e përmbyllur punimin me rezultate dhe rekomandime përkatëse.

Përshëndetjet qofshin mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij!


KAPITULLI I

KOMENTUESIT KLASIKË DHE VIZIONI I TYRE PËR LUFTËN DHE PAQEN ME ARMIQËTË

Në këtë kapitull do të përqendrohemë në shpjegimet e komentuesve klasikë, të dhëna për ajetet kur'anore, që trajtojnë çështjen e paqes dhe armëpushimit me armiqjtë, apo edhe ajetet që trajtojnë çështjen e përgatitjes ushtarake kundër tyre. Po kështu do të diskutojmë edhe për shkaqet e zbritjes së këtyre ajeteve.

1. MENDIMI I IMAM TABERIUT (vdiq 310 h.)

Imam Taberiu apo ‘Mësuesi i komentuesve’, siç e thërrasin dijetarët muslimanë, në komentimin e ajetit 61 të kaptinës el-Enfalë,



Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di."

...thotë: Allahu i Madhëruar i thotë të Dërguarit të Vet: Nëse i frikësoshev tradhtisë së tyre, atëherë vepro njashëm me ta dhe shpallu luftë, por, nëse anojnë nga paqja me ty dhe e braktisin luftën, qoftë duke hyrë në Islam, qoftë duke paguar *xhizjen*, qoftë duke u nënshtruar apo qoftë edhe me çfarëdo forme tjetër të shprehjes së vullnetit për paqe, atëherë ti ano nga paqja dhe afrojua atë që kërkojnë prej teje..."¹

Imam Taberiu, siç mund të vërejmë qartë, ajetin e komenton sipërfaqësisht, duke u ndalur në urdhrin e Allahut të Madhëruar për të Dërguarin e Tij, Muhammedin alejhi's selam, për të anuar nga paqja për sa kohë që atij i ofruar është shansi. Këto janë parimet e fesë sonë të pastër, e cila nuk nxit për luftë dhe derdhje gjaqesh, ashtu siç propagandojnë të tjerët kundër saj.

¹Tefsiri i Taberiut, 14/32, 37, 40.

Ndërsa në komentimin e ajetit 60, nga po e njëjta kaptinë (el-Enfalë)

E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni për rrugën e All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë."

...Imam Taberiu (duke parafrazuar Ibni Abbasin [*Allahu qoftë i kënaqur me të dy*]) thotë: Allahu i Madhëruar thotë se nëse keni frikë se jobesimtarët dhe femohuesit, me të cilët në fakt keni lidhur armëpushim, ju tradhtojnë, atëherë ju – besimtarë – përgatitni për luftë pajisjet e nevojshme, të cilat do t'i frikësonin idhujtarët, armiqjtë e Allahut të Madhëruar dhe armiqjtë tuaj..."² Pastaj, Imam Taberiu citon një hadith pejgamberik, i cili forcën (ar. *el-kuvveh*) e komenton me hedhje (shtizash e shigjetash):

ألا إنَّ القوة هو الرمي، ألا إنَّ القوة هو الرمي”

*Vëni re! Forca është hedhje! Vëni re! Forca është hedhje!"*³

Kësisoj, bazuar në këto shpjegime, del se muslimanët e kanë për obligim që të përgatisin tërë pajisjet ushtarake të nevojshme për ta frikësuar armikun. Nga metodologjia e tradicionalistit Imam Taberiu është dihet se ai Kur'anin e komenton së pari me Kur'an e pastaj me Sunnet, ndërsa ne pamë se në ajet 'forcën' (ar. *el-kuvveh*) e komenton me 'hedhje' (ar. *errremju*), kuptim ky i shkëputur nga hadithi.

² Tefsiri i Taberiut, 14/31.

³ Hadithin e transmeton Imam Muslimi në Sahihun e tij (shën. i përkth.)

Pastaj Imami komenton edhe pjesën e ajetit:

♦•¶+ ♫♪←♪←◎■□↘→♦③ ↗↙+♪♪←♪♦◊□←◎■□↘→♦•¤+
↔♫♪♫♪♫↔□←⑩ ♫♪♫↔□↔□②♫♪♫+♦↗♦□

... *dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-lahu i di ata..."*

...për të cilën jep këto shpjegime: Komentuesit kanë mendime të ndryshme se kush dhe çfarë janë 'të tjerët', si:

- Benu kurejdha,
- Një grup xhinësh

...ndërsa ne si të saktë shohim mendimin se Allahu i Madhëruar i urdhëroi besimtarët që të përgatiten për xihad dhe luftë me të gjitha pajisjet me të cilat e frikësojnë armikun e Tij dhe të tyre, idhujtarët. Nuk ka hapësirë që të thuhet se për qëllim është njëri kuptim dhe jo kuptimet e tjera të forcës, ngase Allahu i Madhëruar e solli atë në formë të përgjithësuar. E nëse thuhet se domethënia e saj është shpjeguar me '*hedhje*' (ar. *err-rremju*) në Sunnet, themi se, megjithëkëtë, hadithi nuk e përkufizon domethënien e saj (forcës) në vetëm '*hedhje*', porse shpjegon një prej shumë domethënieve të saj. Ndryshe, çdo gjë që ndihmon në luftën kundër idhujtarëve është forcë dhe fuqi.

Ndërsa sa i përket mendimit se me 'të tjerët' synohen xhinët, Imam Taberiu e merr për të saktë, përfshirë faktin se besimtarët e dinin kë e kishin armik nga çifutët (beni kurejdhanë) dhe nga idhujtarët – persianët...⁴

Si rezyme do të mund të thuhej se mendimi i Imam Taberit për forcën përfshin çdo gjë që përbën pajisjen e duhur ushtarake të besimtarëve, duke përfshirë këtu të gjitha llojet e armëve, kuajt (mjetet), shpatat, mburojat etj. Pra, shihet se kuptimin e fjalës '*force*' ai nuk e tkurr në domethënien e '*hedhjes*' së ofruar në hadith, të cilën në fakt ai e sheh vetëm si një prej shumë domethënieve të saj.

Kjo transparencë e Imam Taberit dhe hapje e tij në të kuptuarit e tekstit kur'anor, me këto dimensione dhe parametra, është vërtet për t'u lëvduar.


⁴ Ibid.

Allahu i Madhëruar e mëshiroftë Imam Taberiuun dhe e shpërbileftë me xhenetet e Tij!

2. MENDIMI I FAHRUDDIN RAZIUT (vdiq 606 h.)

Para se të shpalosim detaje nga mendimi i Imam Fahruddinit [Allahu e mëshiroftë!] do të doja të thosha se, gjatë shtjellimit të ideve të tij përkitazi me forcën dhe botëkuptimet e saj, kam ardhur në përfundimin se ideja e tij përmban elemente shumë të rëndësishme kulturore, shkencore dhe teknologjike. Ai nuk ka lënë gjë, që ka ekzistuar në kohën e tij e që ka të bëjë me domethënien e ajitet, që nuk e ka përmendur. Kam bindjen se, po të ishte gjallë sot, në kuadër të forcës do të përmendte edhe domethëniet e saj bashkëkohore. Respektivisht, në serinë e botëkuptimeve të *hedhjes* (ar. *err-rremju*) do të radhiste edhe topat, tanket, raketat etj, për shkak se komentimi pejgamberik i forcës nuk i përjashton domethëniet e tjera që të jenë pjesë e saj.

Imami nënvizon edhe rolin e kuajve në luftë në kohën e të parëve (selefitë), që ishin një ndër mjetet më të forta të luftës, e që edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të kenë një rol të pamohueshëm. Pastaj, Imami (Allahu e mëshiroftë!) i qaset edhe qëllimit final të përgatitjes ushtarake, e që është ruajtja e karakterit, e shtetit, e pasurive, e nderit dhe çdo gjëje tjeter që ka vlerë për ta, në mënyrë që kësijoj t'i bëhet e qartë armikut pozita e tyre, e mbas mund të jetë shkak që kjo përgatitje të jetë shkak që armiku ta pranojë Islamin. Në komentin e ajtet:



E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i

dini (se kush janë), e All-lahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni në rrugë të All-lahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë.” (el-Enfalë, 60)

...Fahrudin Raziu thotë: “Dije se Allahu i Lartësuar, kur ia obligoi të Dërguarit të Tij që t'i nxjerrë nga shtëpitë e tyre ata që e prishin marrëveshjen, apo ta thyejë marrëveshjen paraprakisht me ata që ka frikë se do ta bëjnë këtë, në këtë ajet e urdhëroi që të përgatitet kundër atyre të pafeve. Është thënë: Pasi që shokët e Pejgamberit [alejhis salatu ves selam] kishin rënë dakord në betejën e Bedrit që të ballafaqoheshin me të pafetë pa mjete dhe përgatitje (luftarake), Allahu i Madhëruar i urdhëroi që të mos veprojnë kësisoj, përkundrazi, të përgatiten me të gjitha mundësitë: mjete, përgatitje, forcë... Ndërsa qëllimi i fjalës ‘forcë’ (ar. el-kuvveh) këtu janë shkaqet që çojnë tek forca, për çka kanë përmendur:

- Llojet e armëve,
- Gjuajtja, - këtë duke u mbështetur në hadithin, në të cilin thuhet se Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] pas leximit të këtij ajeti kishte thënë: “Forca është gjuajtja!” duke e përsëritur tri herë⁵,
- Kalatë (fortifikatat),
- Çdo gjë që përdoret për t'u forcuar në luftë kundër armikut.”

Sa i përket hadithit “Forca është gjuajtja!”, ai nuk mohon që në ‘forcë’ përfshihen edhe gjëra të tjera përveç hedhjes (gjuajtjes). Ngjashëm me këtë është edhe hadithi: ‘Haxhi është Arafat’, apo hadithi ‘Keqardhja është pendim’, që i japid rëndësi këtyre dy gjérave, por që në rastin e parë, përveç Arafatit ka edhe kushte të tjera, sikurse që në pendim ka edhe kushte të tjera përveç keqardhjes.

Ky ajet dëshmon po kështu se përgatitja për xhihad me zotësi, armë, përvetësim të shkathtësive luftarake dhe gjuajtjes është obligim, por jo për të gjithë (farz kifaje).

⁵ Këtë hadith e transmeton Imam Muslimi në Sahihun e tij, nr. 3541, vëll. 10/32, nga Uke Ibn Amiri, i cili thotë ta ketë dëgjuar të Dërguarin e Allahut [paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi të!] duke thënë në koment të ajetit “*E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake)...*” ndërsa ishte në minber: *إِنَّ الْفُوْزَ الرَّمْنِيُّ إِلَّا إِنَّ الْفُوْزَ الرَّمْنِيُّ إِلَّا إِنَّ الْفُوْزَ الرَّمْنِيُّ إِلَّا إِنَّ الْفُوْزَ الرَّمْنِيُّ* Vëni re! Forca është gjuajtja! Vëni re! Forca është gjuajtja! Vëni re! Forca është gjuajtja!”

କୁଳାରୀଙ୍କ ପାଇଁ ଏହିପରିମାଣରେ କିମ୍ବା ଏହିପରିମାଣରେ କିମ୍ବା

“...e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë)..."

Nuk ka dyshim se kuajt janë mjetet më të forta për xihad. Pastaj, Allahu i Madhëruar na rrëfen se përsë e urdhëroi këtë përgatitje, pra shkakun e saj:



“...e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e All-lahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-lahu i di ata...”

Kjo për shkak se kur të pafetë ta kenë kuptuar se muslimanët janë përgatitur për luftë dhe janë kompletuar me të gjitha mjetet e duhura, kjo do t'i bëjë ata të frikësohen, ndërsa kjo frikë ka dobi, si:

- Nuk ia mësyjnë vendeve islame për t'i sulmuar
 - Ndoshta frika i bën ta paguajnë xhizjen
 - Ndoshta ajo i shtyn që ta pranojnë Islamin
 - Ata nuk do t'i ndihmojnë të pafeve të tjera
 - Kjo do të jetë shkak për avancimin, në kuptimin e zbukurimit më të madh të shtetit islam⁶.

Pastaj Allahu i Madhëruar ka treguar dhe një tjetër urtësi të përgatitjes fizike, e që ka të bëjë me frikësimin e atyre armiqve që ne nuk i njohim, e për të cilët, sipas mendimit më të saktë, është thënë se janë 'hipokritët', e që sipas shpjegimit në këtë kontekst, do t'i binte se, sikur që frikësohen jobesimtarët nga përgatitja e besimtarëve, po kështu frikësohen edhe mynafikët - hipokritët. Por, nëse thuhet se 'hipokritët, që shtiren si pjesë e besimtarëve, nuk kanë frikë se do të luftohen, andaj si të kuptohet kjo?', themi: Frika që mund t'iu shkaktohet atyre është nga dy aspekte:


- Kur të shohin arsenalin ushtarak të besimtarëve dhe fuqinë e tyre të madhe, kjo me gjasë do t'i bëjë ata të mendojnë seriozisht për

⁶ Tefsiri i Raziut, 7/423.

braktisjen e hipokrizisë dhe kthimit në besim të vërtetë, ngase mundësia e mposhtjes së besimtarëve është opsjon i parealizueshëm.

- Është prej natyrës së hipokritëve që t'i shfrytëzojnë rastet për t'i përcarë besimtarët, kështu që, kur të shohin forcën e besimtarëve, frikësohen dhe nuk mendojnë t'i realizojnë planet e tyre të këqija.
 - Besimtari mund të ketë kundërshtarë edhe nga ana e besimtarëve, kështu që është forca ajo që i frikëson edhe këta, sikurse që i frikëson edhe jobesimtarët.⁷


Ndërsa në komentim të ajetit:



Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di.“ (el-Enfalë, 61), Imam Raziu thotë:

“Dije se, pasi që është sqaruar forca dhe demonstrimi i saj që e frikësojnë armikun, është sqaruar dhe ajo se, nëse ata për shkak të kësaj frike anojnë nga paqja, atëherë duhet pranuar armëpushimi – paqja.”

Nadri ka thënë: xheneha err-rrexhulu ila fulanin ve exhneha lehu - idha tabeahu ve hadea lehu ، وأجنب له إذا تابعه و خضع له (جنب الرجل إلى فلان ، وأجنب له إذا تابعه و خضع له) - *xheneha* dhe *exhneha* kanë kuptimin e pasimit dhe nënshtrimit, ndërsa në kontekst të ajetit i bie: nëse ata anojnë nga marrëveshja-paqja, atëherë ano edhe ti! Kurse, pse fjala paqe-marrëveshje (ar. silm) është aluduar me përemrin vtor me gjini femërore (ar. fexhneha *leha*), kjo ngase me të është synuar jo emërtimi, por vetë vepra, sikurse që qëndron dhe në ajetin kur'anor:



⁷ Ibid.

Pastaj Zoti yt, atyre që pasi u torturuan, migruan, mandej luftuan dhe qëndruan, dhe pas të gjitha këtyre vuajtjeve, s'ka dyshim se Zoti yt atyre do t'ua falë dhe do t'i mëshirojë (Ai është që fal, është mëshirues).“ (en-Nahl, 110)

Pra, u përdor përemri i njëjtë, në gjininë femërore, për arsyet se me të synohej veprimi i tyre.

Zemahsheriu, autori i Tefsirit ‘el-Kesh-shaf’, ka thënë: Fjala ‘Silm’ mund të marrë edhe gjininë femërore, sikurse që mund ta marrë edhe e kundërta e saj, fjala ‘Harb’. Poeti ka thënë:


السلم تأخذ منها ما رضيت به - وال الحرب تكتفي من أنفاسها جرع

Nga pagja mund tē marrësh atë që do,

Kurse nga fryssemarrjet e luftës të mjaftojnë ca gllënjkë.⁸

Ajo që vlen këtu të përmendet është se Imam Raziu ndan mendimin e pranimit të marrëveshjes, nëse pala kundërshtare anon nga ajo. Kjo është thënë në kontekst të qenit të muslimanëve faktor përcaktues, pra kur forca dhe fuqia janë në anën e tyre, e jo në rastin e kundërt, pra kur muslimanët janë të dobët, siç kanë thënë disa. Sipas Raziut, edhe nëse kjo marrëveshje është bërë vetëm sa për të mashtruar dhe tradhtuar muslimanët, ajo duhet pranuar, pasi që dispozitat fetare ndërtohen mbi atë që është e manifestueshme - dukshme (ar. *dhahir*) dhe jo mbi të pamanifestueshmet (ar. *batin*). Zoti e di më së miri!

Ndërsa në komentin e ajetit:



Po nëse duan të mashtrojnë me të (me paqen), ty të mjafton All-llahu. Ai është që të fuqizojë ty me ndihmën e Vet dhe me besimtarët.“ (el-Enfalë, 62)

⁸ Tefsiri i Raziut, 7/425.

...Imam Raziu thotë: Allahu i Madhëruar, pasi që në ajetin e mësipërm urdhëroi për paqen, në këtë ajet shtjellon disa prej dispozitave të saj, apo më konkretisht, sqaron se në rast lidhjeje të marrëveshjes nga pala kundërshtare vetëm sa për të mashtruar, kjo lidhje duhet pranuar, ngase dispozita merret për gjëra që janë të dukshme - manifestueshme dhe se marrëveshja, sido që të jetë, nuk është më e fortë se besimi (imani). Përderisa çështjen e besimit e kemi ndërtuar mbi gjëra të manifestueshme (deklarative) dhe jo mbi të tjera, atëherë në këtë rast kjo është më parësore. Mu për këtë ka thënë:

﴿كَذَلِكَ لَقَدْ أَنْتَ مُبَشِّرٌ

Po nëse duan..." (el-Enfalë, 62),

...duke aluduar në ata që janë përmendur më parë, respektivisht:

﴿كَذَلِكَ لَقَدْ أَنْتَ مُبَشِّرٌ إِنَّمَا يَنْهَا الظَّالِمُونَ

Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di." (el-Enfalë, 61)

Por, nëse thuhet, si e komentoni ajetin, në të cilin qëndron:

﴿كَذَلِكَ لَقَدْ أَنْتَ مُبَشِّرٌ إِنَّمَا يَنْهَا الظَّالِمُونَ

Nëse ti e heton tradhtinë e një populli (ndaj marrëveshjes), atëherë edhe ti ua hidh atyre (marrëveshjen) në mënyrë të njëjtë, sepse Allahu nuk i do ata që tradhtojnë (fshehurazi)." (el-Enfalë, 58)


...i cili sikur, sipërfaqësisht, nuk përputhet me ajetin me të cilin argumentojmë, themi: Domethënia e këtij ajeti është se nëse ju vëreni shenja të forta që ata vërtet po duan ta prishin marrëveshjen, ndërsa me tradhtinë e përmendur në ajetin paraprak (ajetin 62 nga kaptina el-Enfalë) synohet ajo që nuk është manifestuar në publik, pra nuk ka shenja të

mashtrimit të qartë se ata duan apo synojnë ndonjë të keqe, porse bëhet fjalë për një lloj hipokrizie dhe mashtrimi. Pastaj, pas kësaj, Allahu thotë:



...ty të mjafton All-lahu..." (el-Enfalë, 62), që d.m.th. të mjafton Allahu që është me ty, dhe të qenit e Tij me ty është e mjaftueshme!¹⁹

Ndërsa, në koment të ajetit 35 nga kaptina Muhammed:



Pra, mos u dobësoni e të kërkon pajtim (armëpushim), kur ju jeni ngadhënjyes dhe All-llahu është me ju dhe nuk ua pakëson veprat tuaja."

...thotë: Pas sqarimit se vepra e jobesimtarit, që formalisht duket si e mirë, është e shkatërruar dhe se mëkati i tij (shirku, pabesimi) është më i keqi, dhe, rrjedhimisht, edhe i pafalshëm, sqaroi se ai nuk ka (nuk meriton) ndonjë respekt në këtë botë dhe as në botën tjetër. Allahu ka urdhëruar që ta respektojmë Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] (Kur'ani: en-Nisa: 92¹⁰) sikurse që ka urdhëruar luftimin e tyre në këtë ajet: “*Pra, mos u dobësoni...*” (Muhammed, 35), që nënkupton se përderisa të gjitha shkaqet janë për të qenë serioz në këtë çështje dhe në xhihad, atëherë mos u bëni të dobët:

“Pra, mos u dobësoni e të kërkonit pajtim (armëpushim).” (Muhammed, 35)

Radhitja në ajetet e sipërpermendura është në kulminacion preciziteti dhe përpikërie. Kjo për shkak se ajeti:

“O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin...” (en-Nisa, 59)

⁹ Tefsiri i Raziut, 7/426.

¹⁰ "O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë."

...parasheh nxitimin për të luftuar, ngase urdhri i Allahut dhe të Dërguarit të Tij për xhihad është pjesë e urdhrit të tyre që duhet respektuar dhe pikërisht për këtë gjë, ky urdhër duhet çuar në vend dhe nuk duhet shfaqur përtaci, neglizhencë apo dobësi në përfilljen dhe zbatimin e tyre. Pastaj, pas përcaktimit¹¹ (parashikimit, nënkuptimit, ar. *el-mukteda*), ndodh që të shfaqet (realizohet) ndonjë pengesë (ar. *el-manië*) e të mos shfaqet (realizohet) shkaktari (ar. *el-musebbib*). Pengesa (ar. *el-manië*) nga lufta mund të jetë e natyrës së kësaj bote por edhe të botës tjetër. Sa i përket asaj të botës tjetër është për shkak se jobesimtari nuk ka respekt dhe vlerë në këtë botë dhe në botën tjetër, për shkak se nuk ka vepra (të pranuara) në këtë botë, ndërsa në ahiret nuk i falen mëkatet. Kësisoj, nëse ekziston shkaku dhe nuk është evidente pengesa, atëherë duhet të realizohet shkaktari (ar. *el-musebbib*). Pengesës së kësaj bote nuk i është dhënë përparësi ndaj ajetit: “*Pra, mos u dobësoni*” (Muhammed, 35), duke aluduar kështu në atë se punët e kësaj bote nuk duhet të jenë pengesë para kësaj. Pra, ju mos u tregoni të dobët ngase fitorja është e juaja, apo, ju duhet të jeni të vendosur që vendosmërinë ta vlerësoni ndaj disfatës¹².

Sipas kësaj që shpjegon Imami, del se në asnje çast nuk duhet lëshuar pe nga xhijadi dhe se, pavarësisht rrethanave dhe shkaqeve që thërrasin apo jo për luftë, për shkak se jomuslimanët janë armiq të Allahut dhe të Dërguarit të Tij si dhe ndaj tyre nuk duhet treguar kurrfarë respekti, nuk duhet qenë tolerantë me ta. Unë nuk di si ta kuptoj këtë qëndrim kur më parë Raziu përmend animin në armëpushim nëse jobesimtarët anojnë, madje edhe nëse nuk janë të sinqertë në qëllimet e tyre. Mendimi i Raziut se jomuslimani nuk ka respekt në këtë botë është çështje e diskutueshme. Terroristët do të mund ta merrnin këtë si mbështetje dhe justifikim për aktet e tyre. Si mund të jetë puna kështu kur Kur'ani na urdhëron të jemi të drejtë dhe të arsyeshëm në raport me ta, sikurse që na urdhëron të polemizojmë me të mirë me ta? Sipas mendimit të Raziut, ne do të duhej t'i çrrënjosnim të gjithë mosbesimtarët. Kjo nuk është praktika kur'anore dhe

¹¹ “*El-mukteda*”, siç qëndron në et-Ta’rifat të Xhurxhanit, (f. 266), nënkupton: Fjali që nuk mund të kuptohet vetveti, vetëm se me futjen edhe të një fjale tjetër në mes. P.sh. ajeti: ‘pyete fshatin’(Jusuf, 82) nuk ka kuptim, po të mos paramendohej ‘pyeti banorët e fshatit’ (shën. i përkth.)

¹² Tefsiri i Raziut, 7/120.

as pejgamberike. Jomuslimanët ekzistonin edhe në të gjallë të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] por nuk është transmetuar që ai të ketë thënë për zhdukjen e tyre nga faqja e dheut. Përkundrazi, ata ishin fqinj të tij, madje ai mori edhe nuse prej tyre, si edhe polemizoi dhe diskutoi me ta për shumë çështje. Vërtet, ata nuk kanë ndonjë vlerë tek Allahu, në botën tjeter, siç ka thënë Allahu:



E Ne i kthehemini ndonjë vepre që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur.”
(el-Furkan, 23)

Ndërsa në dynja, ata kanë fenë e tyre ndërsa ne fenë tonë, ata kanë punët e tyre e ne punët tona. Tek Allahu është takimi ynë. Allahu e di më së miri!

3. MENDIMI I IMAM KURTUBIUT (vdiq 671 h.)

Imam Kurtubiu, në komentimin e ajetit 61 të kaptinës el-Enfalë,

Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di."

...thotë: Allahu i Madhëruar ka thënë se nëse ata anojnë nga paqja, atëherë ano dhe ti. ‘Silmi’ dhe ‘Selami’ (ar. السِّلْمُ وَالسَّلَامُ) kanë kuptimin e marrëveshjes (ar. sulh). Shumica dijetarëve (xhumhuri) e kanë lexuar fjalën “✉✉◆◆✉✉” (fexhnah), pra shkronjën ‘n’ e kanë lexuar me vokalin fet’ha (zanoren ‘e’), derisa Esh’heb el-Ukajliu e ka lexuar me zanoren ‘u.’ Në rastin e parë, leximi është sipas gjuhës së Temimit, ndërsa në të dytin është sipas Kajsit¹³.

Pas komentimit të ajeteve paraprake, Imam Kurtubiu i qaset dhe një tjetër çështjeje, asaj nëse ky ajet është abroguar (ar. nes'h) apo jo. Imami përmend mendimet e ndryshme të dijetarëve nga selefitë si dhe argumentet e tyre, duke ia shtuar kësaj edhe çështjen e periudhës së (zgjatjes së) marrëveshjes.

- 1) Mendimet e atyre që thonë se ajeti është abroguar (anuluar)

Katadeja dhe Ikrimeja, sqaron Imami, ndajnë mendimin se ky ajet është anuluar (vetëm si dispozitë) nga ajetet:

ରେଲ୍‌ଫ୍ରେଶ୍ ଏକ୍‌ସିନ୍‌ମ୍ୟୁଚ୍‌ନ୍‌
ପାର୍କ୍‌ରେ ପାର୍କ୍‌ରେ ପାର୍କ୍‌ରେ

କ୍ଷେତ୍ରମାନଙ୍କ ପରିପାଳନା କାର୍ଯ୍ୟକ୍ରମ
ପରିପାଳନା କାର୍ଯ୍ୟକ୍ରମ ପରିପାଳନା କାର୍ଯ୍ୟକ୍ରମ
ପରିପାଳନା କାର୍ଯ୍ୟକ୍ରମ ପରିପାଳନା କାର୍ଯ୍ୟକ୍ରମ


13 Tefsiri i Kurtubiut, 3/20-22.

E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftojini idhujtarët kudo që t'i gjeni, robërojini dhe ngujojini ata, e vinju pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë ua lëshoni rrugën, se vërtet All-lahu fal, është mëshirues.“ (et-Teube, 5)

Tek All-llahu numri i muajve është dymbëdhjetë (sipas hënës), ashtu si është në librin e All-llahut, prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre katër janë të shenjtë. Kjo është fe e drejtë. Pra, mos e ngarkoni (me mëkat) veten tuaj në ata (katër muaj). Luftojini të gjithë idhujtarët pa dallim, siç ju luftojnë ata juve pa dallim, e dijeni se All-llahu është me ata që ruhen (të këqijave).“ (et-Teube, 36)

Beraeteja (kaptina et-Teube), shpjegojnë këta të dy, ka anuluar çdo marrëveshje tjetër, derisa të dëshmojnë deklaratën islame.

Edhe Ibni Abbasi [*Allahu e mëshiroftë!*] ndan këtë mendim, vetëm se ajetin abrogues e sheh në kaptinën Muhammed, respektivisht ajetin 35 nga kjo kaptinë, e jo nga kaptina et-Teubeh, siç mendonin Katadeja dhe Ikrimeja. Fjala është për ajetin:



Pra, mos u dobësoni e të kërkon pajtim (armëpushim), kur ju jeni ngadhënjes dhe All-lahu është me ju dhe nuk ua pakëson veprat tuaja."

2) Mendimet e atyre që thonë se nuk është abroguar

Ajeti nuk është abroguar. Ajo çka synon ajeti ka të bëjë me pranimin e xhizjes. Kjo për faktin se marrëveshje mbi këtë bazë janë regjistruar në kohën e Omerit [Allahu qoftë i kënaqur me të!] dhe më pas, kur muslimanët, me gjithëqë kishin mundësinë e shkatërrimit të armikut, në rast se këta të fundit e pranonin xhizjen, atëherë ua merrnin atë dhe nuk i luftonin. Madje, vetë i Dërguari i Allahut [alejhis salatu ves selam] ishte ai që e praktikoi këtë gjë. Hajberasve (banorëve të Hajberit) ua dha lejen të ktheheshin në tokat e tyre pasi që më parë qenë mundur, me kusht që të paguanin $\frac{1}{2}$ e të korruvave të tyre. Ebu Is'haku thotë se me këtë kanë qenë për qëllim çifutët e fisit beni kurejdha, ndryshe, xhizja nuk pranohet nga idhujtarët.

Nëse muslimanët kanë primatin e të fortit, atëherë ata nuk kanë pse të anojnë nga marrëveshjet, ndërsa në rast se nuk janë palë vendimtare, apo shohin se ikja nga marrëveshja do të sillte dëme të pariparueshme, lejohet, bile lejohet që vetë muslimanët të fillojnë negociatat për një gjë të tillë. Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] lidhi marrëveshje me banorët e Hajberit dhe marrëveshja vazhdoi e plotfuqishme derisa këta të fundit nuk e shkelën atë, sikurse që lidhi marrëveshje edhe me të tjerë, madje me kurejshët pati një të tillë për dhjetë vjet, derisa atë nuk e thyen kurejshitët. Këtë formë dhe këto aspekte që prezantuan dhe shpjeguan ishin forma që i praktikonin edhe Hulefatë dhe Sahabët [Allahu qoftë i kënaqur me ta!].¹⁴

Imam Kurtubiu, siç mund të shihet, nuk mendon se ajeti është abroguar, vetëm se çështjen e marrëveshjes e lidh shumë me rr Ethanat. Më qartë, nëse muslimanët nuk janë fuqi vendimmarrëse, pra janë të dobët, atëherë

¹⁴ Ibid.

nuk ka tē keqe që madje këta t'ia nisin negociatave për marrëveshje, ndërsa në rast se janë tē fortë dhe janë ata që vendosin rregullat, atëherë marrëveshja nuk bën tē lidhet.

Në shpjegimet e Imam Kurtubiut gjejmë edhe një parim tjetër, atë tē varjes së vendimit nga kreu më i lartë shtetëror - lideri, i cili, në rast se, për shkak tē rrëthanave, sheh se duhet vepruar pro apo kundër marrëveshjes, atëherë duhet vepruar sipas vendimit tē tij.

Pastaj, siç përmendëm më parë, Imam Kurtubiu flet edhe për periudhën e marrëveshjes me armiqtë, dhe për këtë citon Kushejriun tē ketë thënë:

“Nëse forca është në anën e muslimanëve, atëherë marrëveshja nuk duhet tē zgjatë më shumë se një vit, ndërsa, në rastin e kundërt, kur forca nuk është në anën e tyre, atëherë lejohet tē zgjatet deri në dhjetë vjet, por me kusht që kjo periudhë të mos tejkalohet, për shkak se Muhammedi [alejhis salatu ves selam] bëri marrëveshje me mekasit dhjetë vjet.”

Por, për periudhën e marrëveshjes ndërmjet Pejgamberit [alejhis salatu ves selam] dhe mekasve në vitin e Hudejbijes, Ibn el-Mundhiri ka thënë:
Dijetarët ndajnë mendime tē ndryshme:

- 4 vjet, mendim ky i Urves;
- 3 vjet, mendim ky nga Ibni Xhurejxhi;
- 10 vjet, siç thotë Ibni Is'haku, mendim ky edhe i Imam Shafiut, i cili thotë se, duke u bazuar në atë se si veproi Muhammedi [alejhis salatu ves selam] në vitin e Hudejbijes, nuk lejohet tē zgjatet marrëveshja me idhujtarët mbi dhjetë vjet. Ndryshe, nëse ndodh ndonjë zgjatje eventuale mbi këtë periudhë, që është maksimalja e marrëveshjes me idhujtarët, atëherë marrëveshja konsiderohet e prishur, ngase, parimisht, idhujtarët duhen luftuar derisa tē besojnë ose ta japid xhizjen.
- Lejohet marrëveshja pa afat tē caktuar, dhe ky është mendimi që Ibni Hubejbi përcjell nga Imam Maliku¹⁵.

¹⁵ Tefsiri i Kurtubiut, 9/63.

Konsideroj se, për këtë çështje, mendimi më i saktë është ai i Imam Kurtubiut, pasi që gjendja dhe pozita e besimtarëve është ajo që përcakton afatin e periudhës së marrëveshjes. Kësisoj, nuk mund të mbështetemi në mendimet e dijetarëve të hershëm se afati maksimal i marrëveshjes nuk duhet të kalojë dhjetëvjetëshin, ngase rrëthanat e muslimanëve të tashëm janë diametralisht të kundërtat me ato të paraardhësve të tyre. Zoti e di më së miri!


KAPITULLI II

KOMENTUESIT BASHKËKOHORË DHE VIZIONI I TYRE PËR PËRGATITJEN USHTARAKE DHE MARRËVESHJEN - ARMËPUSHIMIN ME ARMIKUN

1. MENDIMI I EBU BEKIR EL-XHEZAIRIUT¹⁶

Komentuesit bashkëkohorë i kanë trajtuar këto ajete nga aspekte të tjera, respektivisht duke u nisur nga disa prej problemeve dhe sfidave të paraqitura në rrafshin politik, ushtarak, ekonomik dhe shkencor. Shejh Ebu Bekir Xhezairiu, në komentin e këtyre ajeteve përmend, së pari, shkaqet e zbritjes - shpalljes së tyre, pastaj, "forcën" (ar. *el-kuvveh*) të përmendur në ajet e shpjegon në përputhje me atë që është transmetuar në hadith, pra me "gjuajtje" (ar. *err-rremju*), për të vazduar më pas me shpjegime se kjo lloj përgatitje sot njihet si 'paqe e armatosur', për shkak se, siç mendon Shejhu, të gjithë jomuslimanët janë armiq të Islamit dhe muslimanëve. Ky mendim i Shejhut nuk mund të hidhet poshtë.

Në komentin e ajeteve 60-61 nga kaptina el-Enfalë:



¹⁶ Ndoshta, sikur të merrnim kriter kohën (kur kanë jetuar këta komentues), këtu do të duhej t'ia fillonim me Sejjid Kutbin, por, për shkak se ky i fundit është thelluar në detaje përkitazi me të drejtat ndërkontaktore, e kemi lënë në fund të këtij kapitulli, për t'u marrë më shumë me të.

ଦେଖିବା ପାଇଁ କିମ୍ବା କିମ୍ବା

E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni për rrugë të All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë. 61. Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek All-llahu. Ai është që dëgjon dhe di.“

...Shejhu thotë: Me rastin e përfundimit të Betejës së Bedrit dhe disfatës së idhujtarëve, si dhe kthimit të tyre në Mekë të mllefosur e plot mëri ndaj muslimanëve, për shkak të së cilës u arrit edhe deri tek Beteja e Uhudit, Allahu i Madhëruar i urdhëroi besimtarët që të përgatiten aq sa kanë mundësi, e tha:

“E ju përgatituni sa të keni mundësi force...” (el-Enfalë, 60)

Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] e ka shpjeguar forcën me hedhje (gjuajtje), dhe këtë në thënien: ‘Vëni re! Forca është gjuajtje!’ - duke e përsëritur tri herë këtë gjë. Pastaj, në pjesën vijuese të komentit të ajetit në fjalë:

"...e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata..."

Shejhu thotë: Pasi që Allahu i urdhëron për përgatitje, iu tregon edhe për qëllimin e saj, që është frikësimi i idhujtarëve që të mos e shohin luftën fare si opzion. Kjo është ajo që njihet si ‘paqja e armatosur’! dhe që Ummitit ia ruan një respekt dhe vend ndërmjet popujve për shkak të frikës. Ndryshe, do t'i vërsuleshin dhe do ta luftonin.

Në komentin e pjesës "...*dhe të tjerët...*" Shejhu thotë se për qëllim janë armiqjtë e tjerë jashtë kurejshitëve. "...*të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata...*" këta, shpjegon Shejhu, mund të jenë ciftetët,

zjarrputistöt, hipokritöt apo edhe xhinöt. Pérderisa Allahu nuk iu ka vënë emër, nuk mund tē thuhet se janë köta dhe jo ata, me gjithë dijen tonë se tē gjithë ata që nuk e besojnë Allahun, njerëz apo xhinë qofshin, janë armiq tē Allahut.

Ndërsa në komentin e ajetit tē dytë (ajeti 61 nga kaptina el-Enfalë):

“Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di.”, Shejhu thotë: Allahu i Lartësuar e urdhëron tē Dërguarin e Tij, që njëherësh ishte komandant i ushtrisë, tē pranojë marrëveshjen kurdoherë që ata anojnë nga marrëveshja sinqerisht, ngase Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] është dërguar mëshirë dhe jo ndëshkim pér njerëzimin. Po kështu e urdhëroi që t'i mbështetet Allahut në këtë gjë, pra ta pranojë armëpushimin dhe t'i mbështetet Atij, ngase A i mjafton kundër sherrit dhe tē këqijave tē tyre¹⁷.

Pastaj Shejhu përmend mësimet e nxjerra nga ajetet dhe, duke pasur parasysh faktin se është pjesë e këtij shekulli, ai forcën e komenton me çdo armë tē zbuluar dhe prodhuar nga njeriu, duke sqaruar se kjo, parimisht, nuk bie ndesh me paqen, pérderisa kryhet si pjesë e asaj që ai e quan ‘paqe e armatosur.’

Mësimet e përfituara nga ajetet

- 1) Përgatitja ushtarake çdoherë, sipas rrethanave dhe në përputhje me kohën. Pra, nëse në tē kaluarën kjo nënkuptonte përgatitjen e kuajve dhe tē shtizave, sot nënkupton përgatitjen e mjeteve tē sofistikuara tē luftimit, si tanket, raketat etj.
- 2) Aprovimi i parimit ‘Paqja e armatosur’.
- 3) Muslimanët është e pamundur tē mos kenë armiq, ngase tē këqijtë, njerëz apo xhinë qofshin, janë armiq tē tyre.
- 4) Shpenzimi pér xhihad është prej rrugëve më tē mira dhe më dobiprurëse pér besimtarin në botën tjetër.
- 5) Armëpushimi pranohet apo refuzohet varësisht nga rrethanat.¹⁸

¹⁷ Xhezairi, Ebu Bekir. Ejseru-t-tefasir. 2/51-52.

¹⁸ Ibid. 2/53.

- 6) Konsideroj se mendim i Shejhut është i peshuar dhe i matur mirë. Unë pajtohem me shpjegimin e tij për 'forcën' dhe e përgëzoj për këtë kapacitet dhe dije të mirë e të madhe!

2. MENDIMI I ISH-SHEJHUT TË EZ'HERIT, DR. SEJJID TANTAVIT (vd. 2010)

Mendimi i Dr. Tantavit anon më shumë nga klasikët, edhe pse gjatë studimit më ka rënë të vërej një detaj që tek komentuesit e tjerë nuk e kam hasur. Ky detaj ka të bëjë me një aspekt gjuhësor. Shejhu kishte vënë re se në ajet është përdorur pjesëza kushtëzuese ‘^ül’ (nëse) që flet për joseriozitetin e tyre në kërkesën për armëpushim, edhe pse mendon se marrëveshja dhe armëpushimi duhet lidhur me kujdesin maksimal. Le të shkoqisim pjesë nga komentimi i tij për ajetet 61-63 të kaptinës el-Enfalë:

ଓঁ শ্রী কৃষ্ণ পদবী পূজা মন্ত্র পাঠ ও অর্পণা করে আপনার পুত্র সন্তান এবং পুত্রসন্তানের জন্য।

Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek All-llahu. Ai është që dëgjon dhe di. 62. Po nëse duan të mashtrojnë me të (me paqen), ty të mjafton All-llahu. Ai është që të fuqizoji ty me ndihmën e Veti dhe me besimtarët. 63. Dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzoje gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t'i bashkoje zemrat e tyre, por All-llahu bëri bashkimin e tyre, pse Ai është i gjithëfuqishëm, i urtë.“

...O ti i Dërguar, ndëshkoji në luftë ata idhujtarë dhe femohues që prishin marrëveshjet çdoherë, si dhe përgatitu ushtarakisht që t'i frikësosh, e pastaj, nëse ata anojnë nga paqja dhe armëpushimi, pranoje këtë përderisa keni dobi në të, ngase Allahu këtë anim të tyre ndaj paqes dhe marrëveshjes e shpreh me pjesëzën ‘ul’ (nëse) që nënkupton dyshimin se ajo mund të ndodhë. Më qartë, ajeti aludon në atë se jobesimtarët nuk janë

të denjë për të lidhur marrëveshje me ta, ngase ata nuk e lidhin marrëveshjen për hir të marrëveshes dhe paqes, por për shkak të ndonjë interesи (ose përfitimi në kohë), kështu që besimtarët duhet të jenë çdoherë të kujdeshëm dhe vigjilentë...¹⁹

Ndoshta, vazhdon Dr. Tantavi, mendimi më i saktë është ai i Zemahsheriut, autorit të Kesh-shafit, që thotë se marrëveshja i lihet në dorë prijësit të muslimanëve, i cili vendos për të, nëse sheh dobi dhe interes për muslimanët. Jo çdoherë, detyrimisht muslimanët duhet të luftojnë ose të lidhin paqe. Ajeti është një motivim dhe nxitje për Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*] për të vazhduar rrugën e luftës ose paqes, varësisht nga rrethanat, duke e përgëzuar për fitoren, madje edhe në rast se jobesimtarët anojnë nga marrëveshja vetëm sa për të tradhtuar e mashtruar.²⁰

Kjo urtësi që ka vënë re Dr. Tantavi [*Allahu e mëshiroftë!*] është e rëndësishme sidomos për kohën kur muslimanët nuk janë faktor në nivel botëror. Këtë gjë e kanë neglizhuar shumë prej atyre që kanë lidhur paqe dhe armëpushime me jomuslimanët në kohën tonë. Ata nuk kanë arritur ta kuptojnë esencën dhe bërthamën e kësaj të vërtete. Nuk mund të pranojmë armëpushimet me kushtin që jobesimtarët të pushtojnë vendet tona, të shkatërrojnë shtëpitë dhe pasuritë tona, të çnderojnë vajzat dhe gratë tona. Si mund të paramendohet një armëpushim i tillë?!

¹⁹ Tantavi, Sejjid. Et-tefsir el-vesit. 1/1860-1863.

²⁰ Ibid.

3. MENDIMI I SEJJID KUTUBIT (vdiq 1966)


Se Tefsiri i Sejjid Kutubit, i shkruar me ngjyrë dhe gjak, shquhet nga tefsirët e tjera për dimensionet kulturore, shoqërore, politike, morale dhe ekonomike, është çështje që nuk e vë në në pikëpyetje askush. Ishte metodologji e Rahmetliut që ajetet t'i klasifikonte sipas tematikave dhe mësimeve të përfituar, për ta lehtesar më pas kështu kuptimin dhe praktikimin e tyre.

Fakti se autor i është bashkëkohor dhe ka përjetuar zhvillimet e hovshme teknologjike, por edhe ka përcjellë nga afër komplotet që i bëheshin Ummetit Islam nga armiqtë e tij në të gjitha sferat: shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, morale, e që në fakt viktimë e këtyre komplateve ishte edhe vetë, pasi i pagoi me jetë qëndrimet e tij fetare, i mundësuan atij të kuptojë thallisht dhe në detaje të vërtetën përkitazi me to, e rrjedhimisht, edhe të marrë qëndrim dhe të vihet në ballë të frontit kundër tyre. Për këtë arsy, ne do të ndajmë kohë dhe hapësirë më shumë për Sejjid Kutubin se për *mufessirët* e tjera bashkëkohorë, në mënyrë që t'i japim lexuesit mundësinë të kontaktojë drejtpërdrejt me tekstin e tij për këtë çështje, studimin e të cilës jemi duke e bërë këtu. Arsyja pse unë kam vendosur të veproj kështu është që ta mbroj drejtpërdrejt personalitetin e tij nga akuzat që i janë bërë nga hulumtues muslimanë dhe jomuslimanë, se kinse ai e ka fajin për nxitje të dhunës dhe shkëputjes së marrëdhënieve me jomuslimanët. Autori (S.K.) është i pastër nga këto akuza. Përkundrazi. Ai, për çështjen në fjalë, ka bërë studimin më original, studim të cilin e ka mbështetur në Kur'an, Sunnet dhe në ngjarje të sakta historike. Mendimin e tij ai na e shpreh në komentimin që iu bën ajeteve të kaptinës el-Enfalë, në të cilën ajetet janë të lidhura tematikisht me njëra-tjetërën dhe kanë një kontekst të përgjithshëm. Ato thuajse sikur trajtojnë vetëm një temë, andaj edhe komentimi i tyre është i përbashkët (i lidhur me pjesët e para dhe të pasme të ajeteve në fjalë). Në fillim të komentimit, Kutubi përmend disa dispozita juridike dhe mësimet e urtësitë që nxirren dhe përfitohen prej kaptinës, për të cituar më pas Ibnu-l-Kajjimin dhe klasifikimin e njerëzve

sipas qëndrimeve të tyre karshi Thirrjes Islame që nga dërgimi i Muhammedit [alejhis salatu ves selam] e deri në vdekjen e tij. Nuk do të donim që tani, paraprakisht, të japim vlerësimin tonë për atë se ia ka dalë apo jo që të komentojë shkencërisht dhe në përputhje me ajetet dhe hadithet apo jo. Këtë gjë do t'ia lëmë lexuesit të nderuar që ta bëjë vetë, pasi që më parë do të ketë mundësinë të përfjetojë flladin e domethënieve dhe kuptimeve të këtyre ajeteve. Në fakt, ajo që dua të sqaroj tani ka të bëjë me mospajtimin tim për përdorimin e disa shprehjeve nga Sejjid Kutubi, të cilat sikur reflektojnë botëkuptime dhune, force, vrazhdësie, si: 'Organizata e Ndaluar Ushtarake', 'Kampi Islam', 'Liga Muslimane' etj, për shkak se terma si këto mund të jenë shkak i debateve të nxehta në qarqe politike për shkak të rrethanave nëpër të cilat po kalojnë muslimanët. Mendoj se do të kishte qenë më mirë sikur Profesor Kutubi të përdorte shprehje të tjera, si 'Shteti Islam', 'Shteti Musliman', 'Muslimanët e Parë', 'Vatra Islame' etj. Në të vërtetë, Prof. Kutbi termin 'Vatër Islame' e përdor në shkrime të tjera, por nuk di pse jo edhe këtu, për të mos i hapur gojën kritikëve dhe kundërshtarëve për ta akuzuar vazhdimisht. Ku ta dimë, ndoshta qëndrimi i tij për një kohë të gjatë në Amerikë, atje ku edhe kreu studimet postdiplomike dhe ku pa komplotet që organizoheshin kundër Islamit dhe muslimanëve, sikurse edhe aftësia e tij oratorike dhe letrare, kanë bërë që ai t'i përdorë ato në vend të shprehjeve tjera?!

Profesor Kutbi [*Allahu e mëshiroftë!*] sqaron se disa nga dispozitat e përmendura në këtë kaptinë, janë periodike dhe se forma e prerë e tyre është shpallur në kaptinën et-Teube. Kushdo - sqaron profesori - që përcjell ngjarjet e historisë islame dhe ndodhitë e zbritjes së ajeteve, do ta kuptojë lehtë këtë të vërtetë. Kësisoj, deshëm apo jo, për të nxjerrë mësimë, urtësi dhe dispozita të prera kur'anore përkitazi me atë se çfarë nënkuption përgatitja e forcës dhe lidhja e marrëveshjeve (armëpushimeve) me armiqtë, duhet të studiojmë ngjarjet historike për të gjetur nëse përputhen apo jo, apo se njërsë i duhet dhënë përparësi, si më e saktë, ndaj tjetrës (duhet bërë *teufik* ose *terxhih*).

Në komentin e ajeteve 55-62 nga kaptina el-Enfalë:



Krijesat më të dëmshme tek All-llahu janë ata që mohuan, nuk pritet që ata të besojnë; 56. Këta janë ata prej të cilëve ti pate marrë premtimin (se nuk do t'i ndihmojnë idhujtarët), e të cilin ata nuk e ruajtën por si çdo herë e thyejnë premtimin e tyre. 57. Po nëse i ndesh (i zë) ata në luftë, atëherë ti me ta (me shkatërrimin e tyre) shpartallo ata që të marrin mësim. 58. Nëse ti e heton tradhtinë e një populli (ndaj marrëveshjes), atëherë edhe ti ua hidh atyre (marrëveshjen) në mënyrë të njëjtë, sepse All-llahu nuk i do ata që tradhtojnë (fshehurazi). 59. Dhe ata që mohuan, mos të mendojnë kurrsesi se shpëtuan (se na ikën). Ata nuk mund ta bëjnë të paaftë Atë (Zotin) që i ndjek. 60. E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni në rrugë të All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë. 61. Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek All-llahu. Ai është që dëgjon dhe di. 62. Po nëse duan të

mashtrojnë me të (me paqen), ty të mjafton All-llahu. Ai është që të fuqizojë ty me ndihmën e Vet dhe me besimtarët.”

...Sejjid Kutubi jep këto shpjegime: Ky mësimi i fundit nga kaptina el-Enfalë përmban shumë rregulla:

- 1) si duhet të sillemi me kampe të ndryshme gjatë paqes dhe luftës;
- 2) organizatat e brendshme të shoqërisë muslimane dhe raportet e tyre me ato të huajat;
- 3) qëndrimi islam përkitazi me marrëveshjet dhe konventat në fusha të ndryshme;
- 4) qëndrimi islam përkitazi me lidhjet e gjakut, gjinisë dhe tokës dhe lidhjet e besimit.

Nga këtu kuptohet se disa prej dispozitave kanë karakter përfundimtar, ndërsa të tjerat, për shkak të rr Ethanave, kanë qenë të përkohshme. Në fakt, ato kanë përjetuar disa ndryshime në kaptinën et-Teube, me çka kanë marrë karakter përfundimtar. Ja disa nga këto dispozita, siç kanë ardhur në kontekstin kur'anor:

- 1) Ata që njëherë lidhin armëpushim me *Kampin Islam* ndërsa më pas e thyejnë atë, ata janë krijesat më të shëmtuara, ata janë (njerëz) që duhen edukuar frikshëm, në mënyrë që të tremben dhe llahtarisen ata dhe gjithë të tjerët që mendojnë sikur ata (ta thyejnë marrëveshjen) apo kanë në mendje ta sulmojnë *Kampin Islam*.
- 2) Në rast se Udhëheqja parashev mundësinë që pala me të cilën është lidhur marrëveshja mund të tradhtojë apo ta thyejë marrëveshjen, atëherë ata kanë të drejtë ta prishin të parët marrëveshjen dhe ta lajmërojnë palën tjetër për anulimin e saj, për të krijuar më pas mundësinë e luftimit të tyre por edhe të edukimit dhe frikësimit të tyre dhe të tjerëve që mendojnë sikur ata.
- 3) Kampi Islam duhet të jetë në kulminacion të përgatitjes dhe përherë i gatshëm, në mënyrë që ‘*Forca Udhëzuese*’ (Islami) të jetë forca më e madhe në tokë, të cilës do t’ia kenë frikën të gjitha forcat e së keqes:
 - a) Duke mos pasur guximin për ta sulmuar Vatrën Islame, fillimisht,
 - b) Pastaj, duke iu nënshtuar pushtetit të Allahut dhe duke mos penguar Thirrësin Islam në tokat e veta
 - c) Po kështu, duke mos penguar askënd nga vendet e tyre t’i përgjigjet Thirrjes Islame,
 - d) Duke mos guxuar të pretendojnë të drejtën e sundimit dhe nënshtimit të njerëzve, dhe

e) Në mënyrë që feja të jetë e tëra për Allahun!

Ajo që mund të vërejmë nga shpjegimet e Profesor Kutubit është përgjithësimi i forcës dhe fuqisë, pra ai nuk flet për lloj të caktuar fuqie apo mjetesh, ashtu siç ka ardhur në Kur'an, sikurse që nuk e shohim të japë detaje rreth të vërtetës përkitazi me të dhe domethënien e saj, siç kanë bërë komentues të tjerë. Ai -citoj- thotë: “...përgatitja ushtarake duhet të jetë e përhershme dhe në kulminacion, në mënyrë që Forca Udhëzuese të jetë ajo më e larta në tokë.”

Ndoshta Profesor Kutubi këtë nuk e ka bërë pa ndonjë qëllim të caktuar. Ai mbasë ka aplikuar metodologjinë kur'anore për të heshtur ndaj disa gjërave, në mënyrë që detajet për to të përcaktohen varësisht nga koha dhe rrëthanat, si: mjetet me të cilat përcaktohet forma e organizimit të Mexhlisi Shura-së (Parlamentit), Gjykatave Islame, zgjedhjes së Presidentit etj. Mjetet e realizimit të këtyre gjërave, feja i ka lënë në dispozicion të përcaktimit në përputhje me kohën dhe vendin. Zoti e di më së miri!

- 4) Në rast se një grup jomuslimanësh anojnë nga paqja me Kampin Musliman, atëherë marrëveshja pranohet dhe lidhet me ta, edhe nëse ata nuk janë të sinqertë, përveç në rastet kur kjo vërehet ashiqare. Në të kundërtën, çështja e tyre i lihet Allahut. Ai iu mjafton besimtarëve kundër të ligave të tradhtarëve!
- 5) Xhahidi, pavarsisht se sa më i madh mund të jetë numri i kundërshtarëve, është obligim (farz). Ata janë të përkrahur dhe të ndihmuar nga Allahu dhe çdonjëri prej tyre mund të krahasohet me dhjetë nga pala armike. Kjo nënkupton se obligimi i Xhahadit nuk pret plotësimin e barazisë ndërmjet besimtarëve dhe armiqve të tyre. Muslimanët le të përgatisin atë që kanë, le të mbështeten tek Allahu, le të qëndrojnë të ngulitur në fushëbetëjë dhe të durojnë, ndërsa për pjesën tjetër do të kujdeset Allahu. Kjo për shkak se ata janë të përkrahur edhe me forca të tjera jomateriale, që nuk mund t'i shohë syri i njeriut.
- 6) Kampi Musliman, apriori, do të duhej ta ketë qëllim zhdukjen dhe çrrënjosjen e forcës së tiranëve dhe despotëve, duke shkatërruar çdo shkak force. E, nëse zënia rob dhe lirimi me shpagim i tyre nuk do t'i kontribuonte këtij ideali (kësaj objektive), atëherë një gjë e tillë nuk do të merret si opzion. Kjo për shkak se të Dërguarit [alejhimu-s-selam] dhe pasuesit e tyre nuk duhet të kenë robër përderisa të mos kenë shkatërruar forcat kundërshtare dhe të mos kenë mbizotëruar në tokë. Kështu, në rast se Kampi Musliman ka mbizotëruar, atëherë

ata mund të kenë robër, ndryshe, vrasja në beteja është më parësore dhe më e dobishme...²¹

- 7) Ashtu siç është e lejuar marrja e pasurisë për shpagimin material të të zënëve robër, kuptohet pasi që besimtarët të kenë ngadhënjer dhe t'ia kenë këputur kokën të keqes, po kështu lejohet edhe marrja e presë së luftës.
- 8) Të zënëve robër në Kampin Musliman duhet t'iu ofrohet Islami dhe duhet të nxiten për ta pranuar atë, ngase premtimi i Allahut me shpërblim për këtë (pranimin e Islamit nëpërmjet duarve tona) është më me rëndësi se sa të merret preja ose shpagimi material prej tyre. Gjithsesi duhet t'iu tërhiqet vërejtja për tradhtinë e mundshme.

Këto janë, përgjithësisht, disa nga parimet dhe rregullat që përban ky mësim: ato, në fakt, paraqesin një korpus rregullah me vlerë të sistemit të brendshëm dhe të jashtëm islam. Në vijim po paraqesim diç nga këto rregulla:

- 1) Këto ajete kanë trajtuar praktikisht jetën shoqërore në Medinë, jetën e komunitetit musliman dhe kanë pajisur elitën udhëheqëse me norma dhe parime se si t'i qasen kësaj gjendjeje dhe situate. Ato paraqesin edhe një nga konceptet e para zhvillimit të marrëdhënieve të jashtme ndërmjet kampit musliman dhe kampeve të huaja, që nga pikëpamja përbajtjesore nuk kanë ndryshuar as më vonë. Janë bërë kryesisht ndryshime plotësuese, por, në esencë, ka mbetur si rregull themelor në marrëdhëni ndërkombëtare në Islam.
- 2) Ajetet konfirmojnë mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve ndërmjet kampeve të ndryshme, me kusht që ato të ruhen nga prishja dhe shkelja e tyre. Paqja e lidhur duhet të respektohet, por nëse pala tjetër lidhjen e paqes e merr vetëm si mundësi për të tradhtuar dhe mashtruar, atëherë palës islame i takon ta prishë këtë marrëveshje duke e informuar palën tjetër për prishjen e saj. Tashmë është në dorën e palës islame ta sulmojë kur të dojë palën tjetër dhe të shfaqë ashpërsi në mënyrë që t'i frikësojë të gjithë ata që ia duan të keqen shoqërisë islame, qoftë nëse e shprehin apo e fshehin këtë. Ndryshe,

²¹ Kutb, Sejjid. Fi dhilali-l-Kur'an. 3/425-428.

me të tjerët, të cilët sipërfaqësish shihen se nuk kanë prapavijë, marrëveshja me ta ruhet dhe respektohet....²²

Pas përmendjes së këtyre rregullave fetare në parathënien e komentimit të kaptinës el-Enfalë, Kutubi përshkruan situatën dhe gjendjen në të cilën u shpallën këto ajete si dhe qëndrimet e njerëzve karshi Thirrjes Islame. Në fakt, ai flet për periudhën e parë të elitës komanduese muslimane në Medinë, fill pas hixhretit, për çka citon dijetarë duke filluar me Ibnul Kajjimin [*Allahu e mëshiroftë!*], i cili thotë: Kur Muhammedi [alejhis salatu ves selam] erdhi në Medinë, jobesimtarët, në raport me të, morën këto tri pozicione:

- 1) Një grup pranoi të lidhte marrëveshje me të, me kusht që të mos e luftonin, të mos ngriheshin kundër tij dhe të mos përkrahnin armiqtë e tij, ndërkohë që do të mbeteshin të sigurt në besimin, gjakun dhe pasurinë e tyre.
- 2) Një grup e luftuan dhe morën qëndrim armiqësor.
- 3) Grupi i tretë as nuk lidhi paqe me të por as nuk e luftoi. Ata prisnin se në anën e kujt do të ishte fitorja që të shkonin me të. Prej tyre kishte individë që dëshironin ngadhënjimin e Muhammedit [alejhis salatu ves selam], por kishte edhe të tjerë, që donin fitoren e armiqve. Këta ishin hipokritët. Muhammedi [alejhis salatu ves selam] u soll me secilin grup ashtu siç e urdhëroi dhe mësoi Allahu i Madhëruar.

Prej atyre me të cilët lidhi paqe ishin fiset çifute rrëth Medinës, si: Benu Kajnukaë, Benu Nadiri, Benu Kurejdha, sikurse që në mesin e tyre kishte edhe fise idhujtare që jetonin përreth Medinës. Ajo që shihet është se këto rrëthana kanë qenë të përkohshme dhe janë ballafaquar me situatën aktuale. Ato norma nuk kanë qenë përfundimtare në marrëdhëniet islame ndërkombëtare, përkundrazi, kanë ndryshuar në vazhdimësi, derisa kanë zbritur ajetet në kaptinën el-Berae (et-Teube)...²³

Ajo që vërejmë tek Profesor Kutubi është edhe interesimi i madh për historinë dhe Siren Pejgamberike, pasi që shpesh ai i referohet thënieve të

²² Kutb, Sejjid. *Fi dhilali-l-Kur'an*, 3/427-428.

²³ Kutb, Sejjid. *Fi dhilali-l-Kur'an*, 3/427-428.

dijetarëve nga gjeneratat e para - selefitë për të induktuar historinë e vërtetë, për të përfunduar më pas tek zhvillimi i Thirrjes Islame dhe pikat ku ka arritur në fund të çështjes. Kjo padyshim është metodologji shkencore dhe e qëndrueshme e Profesor Kutubit në komentimin e Kur'anit. Kjo ngase, kur bëhet fjalë për trajtimin e ngjarjeve dhe ndodhive pejgamberike, respektivisht përfitimin e normave periodike dhe të atyre të formës së prerë që kanë të bëjnë me luftimin dhe lidhjen e marrëveshjes (paqes) me armiqtë, ne e gjemë prapë Profesor Kutubin t'i referohet Ibnul Kajjimit, ku tekstualisht thotë: Për periudhat nëpër të cilat kanë kaluar këto marrëdhënie (lidhje) kemi folur në pjesën e nëntë, në të cilën kemi sjellë rezymenë e asaj çfarë ka thënë Ibnul Kajjimi në (librin e tij) Zadul Mead, përsëritjen e së cilës e shohim këtu si të dobishme:

Kapitull mbi radhitjen e kontekstit të udhëzimit të të Dërguarit të Allahut [Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!], përkitazi me raportet me mosbesimtarët dhe hipokritët nga dërgimi e deri në vdekjen e tij... Citatet e para që iu shpallën nga Zoti i tij janë:



Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).“ (el-Alek, 1)

Kjo, sigurisht, në fillim të pejgamberisë së tij. Allahu e urdhëron që ta lexojë atë në vete dhe jo ta kumtojë. Pastaj, i shpallen citatet:



O ti i mbuluar! 2. Ngrihu dhe tērhiyu vērejtjen (duke i thirrur).“ (el-Muddeeththir, 1-2)

Kësisoj, e lajmëroi me "Lexo!" (ar. *Ikre!*) ndërsa e dërgoi me "O ti i mbuluar!" (ar. *Ja ejjuhel muddeththir!*), për ta urdhëruar më pas për t'i ftuar familjen dhe të afërmit, e për të vazhduar më pas me popullin e tij, pastaj arabët që i kishte përreth, arabët në përgjithësi, për të mbaruar krejt në fund me gjithë njerëzimin. Për më shumë se dhjetë vite vazhdoi të kumtonte pa aplikuar luftën apo xhizjen. Urdhërohej për vetëpërmbytje,

durim, falje... Pastaj u urdhërua ta bënte hixhretin, si dhe iu lejua lufta. Pastaj u urdhërua të luftonte ata që e luftonin dhe t'i shmangete ata që nuk e luftonin. Pastaj u urdhërua t'i luftonte idhujtarët derisa feja të ishte vetëm e Zotit.

Klasifikimi i jobesimtarëve, pas marrjes së urdhrit për xihad, ishte:

- 1) Palë, me të cilët kishte lidhur paqe dhe marrëveshje
- 2) Armiq lufte
- 3) Ehlu dhimmeh (jomuslimanë nën protektoratin e shtetit islam).

Me ata që kishte lidhur marrëveshje, u urdhërua ta plotësonte atë, përderisa ata vetë nuk e prishnin. Në rast se i frikësohej tradhtisë së tyre, mund ta prishte marrëveshjen, por jo domosdo edhe t'i luftonte ata, përderisa nuk i lajméronte për prishjen e saj (marrëveshjes.) Ndërsa ata që e prishnin marrëveshjen, u urdhërua t'i luftojë. Kur zbriti kaptina et-Teube, atëherë u sqaruan edhe normat përkatëse për këto tri grupe:

- 1) E urdhëroi t'i luftonte armiqtë, nga radhët e Ithtarëve të Librit, derisa ta jepnin xhizjen ose ta pranonin Islamin.
- 2) E urdhëroi t'i luftonte jobesimtarët dhe hipokritët, si dhe të tregohej i ashpër ndaj tyre. Jobesimtarët t'i luftonte me shpatë, ndërsa hipokritët me argumente.
- 3) E urdhëroi t'i prishte marrëveshjet, ndërsa trajtimin e atyre me të cilët kishte marrëveshje e kategorizoi në tri pjesë:
 - a) Një grup, që e kishin thyer marrëveshjen dhe nuk i kishin qëndruar besnikë, - e urdhëroi t'i luftonte. Kështu, ai i luftoi dhe triumfoi mbi ta.
 - b) Një grup tjeter, të cilët kishin një marrëveshje të përkohshme, por që nuk e kishin thyer atë, - e urdhëroi ta ruante marrëveshjen me ta deri në afatin e skadimit.
 - c) Grupi me të cilin kishte marrëveshje dhe që nuk e kishte luftuar atë, ose që kishin marrëveshje të përhershme, - e urdhëroi t'i afatizonte katër muaj, pas të cilëve, më pas, do t'i luftonte.²⁴

²⁴ Kutb, Sejjid. *Fi dhilali-l-Kur'an*, 3/425; 428; 430.

Në vijim, Sejjid Kutubi, përmend një koment të shkëlqyer, të cilin, konsideroj, sikur ta lexonin jomuslimanët, ata do të kishin plotësisht qëndrime të tjera, pasi do të kuptionin të vërtetat islame që nga koha e shpalljes e deri më sot.

“Këto tekste duhen studiuar në dritën e këtyre konsideratave... të cilat, me gjithëqëaprovojnë disa rregulla bazike, prapë ato nuk janë forma përfundimtare. Në të vërtetë, formën përfundimtare të tyre e sjell kaptina el-Beraeh (et-Teubeh) dhe praktikat e aplikuara në fund të jetës së të Dërguarit të Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*], siç do të mësojmë më vonë. Ata, në sigurinë e të cilëve nuk mund të zërë vend askush, nuk meritojnë të jenë vetë të sigurt. Shpërblimi i tyre është privimi nga siguria, ashtu siç ata i kanë privuar të tjerët. Ata duhen frikësuar dhe duhen dëbuar. Nga këto veprime nuk do të ishin të vetmit ata që do të frikësoheshin, por edhe ata që qëndrojnë prapa tyre apo që ndajnë mendime të ngjashme me ta. I Dërguari i Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] dhe besimtarët pas tij, janë të urdhëruar që kur të ndeshen me të tillët, të veprojnë kësijo:

କ୍ରମିକ ପାଇଁ ଏହାରେ କିମ୍ବା
ଏହାରେ କିମ୍ବା ଏହାରେ କିମ୍ବା

Po nëse i ndesh (i zë) ata në luftë, atëherë ti me ta (me shkatërrimin e tyre) shpartallo ata që të marrin mësim." (el-Enfalë, 57)."

Është kjo natyra e programit, imazhi i të cilit duhet të rrënjoset thellë në zemrat e palës muslimane. Kjo fe duhet të respektohet. Asaj i duhet forca. Ajo doemos duhet t'i frikësojë ata, tiranët. Ajo duhet ta çlironjë njeriun në tokë nga cdo formë tiranie dhe dhune.

Ata që mendojnë se misioni i kësaj feje, në raport me tiranët, përkufizohet vetëm në kumtim, e kanë gabim. Ata nuk e njohin Islamin.

Kjo është dispozita e parë, ndërsa e dyta ka të bëjë me gjendjen e frikës së prishjes së mundshme të marrëveshjes dhe tradhtisë. Kjo ndodh atëherë kur shfaqen shenja se pala kundërshtare është e interesuar për prishjen e marrëveshjes:

ମେହିରାଜ ପାତ୍ର କରିବାର ପାଇଁ ଏହାର ପାଇଁ ଏହାର ପାଇଁ ଏହାର ପାଇଁ

Nëse ti e heton tradhtinë e një populli (ndaj marrëveshjes), atëherë edhe ti ua hidh atyre (marrëveshjen) në mënyrë të njëjtë, sepse All-lahu nuk i do ata që tradhtojnë (fshehurazi).” (el-Enfalë, 58)

Islami lidh marrëveshje, që të ruhet marrëveshja e tij, e nëse vëren se ajo po prishet, atëherë e prish atë. Dhe kjo nuk është tradhti dhe as mashtrim. Islami me këto veprime e ngre njeriun në një piedestal dhe shkallë të lartë prehjeje dhe qetësie shpirtërore. Islami nuk është ai që e thyen marrëveshjen. Nuk është ai që i befason ata me të cilët është në marrëveshje me sulme të papritura. Madje këtë nuk e bën as në raport me ata prej të cilëve pritet tradhtia dhe prishja e marrëveshjes. Ndërsa me ata që e kanë prishur marrëveshjen, atëherë në raport me ta '*lufta është mashtrim*', për shkak se secila palë kundërshtare ka marrë vërejtjet dhe paralajmërimet paraprake. Kështu, nëse është lejuar mashtrimi i palës kundërshtare, kjo nuk do të thotë se është tradhtuar, porse se ajo ka qenë e pakujdeshme dhe neglizhente. Kësisoj, të gjitha mjetet e mashtrimit janë të lejuara ngase nuk janë tradhti.

Islami e urren tradhtinë, si dhe urren e nënvlerëson tradhtarët dhe ata që prishin (thyejnë) marrëveshjet. Islami, për këtë shkak, nuk lejon që muslimanët t'i thyejnë marrëveshjet, pavarësisht qëllimeve fisnike që mund të kenë.

Dua të përmend me këtë rast se ‘Ligji i xhunglës’ ka vazhduar të mbretërojë në shoqëritë evropiane deri në shekullin e XVIII-të. Ato nuk kanë pasur kulturë të raporteve ndërkontaktore, përveç asaj që mund ta kenë huazuar nga ligji islam. Në të vërtetë, ato ende nuk kanë ndonjë ligj që mund të jetë në nivel të ligjit islam. Ndërsa atyre që mashtrohen me avancimin stilistik në krijimin e ligjeve, iu themi le t'i kthehen realitetit

nëse duan ta kuptojnë të vërtetën ose atë që e dallon ligjin islam dhe të gjitha sistemet e kohës sonë.²⁵

Në komentin e ajetit 60 nga kaptina el-Enfalë:

E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni në rrugë të All-llahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë."

...Profesor Kutubi thotë: "Përgatitja, e cila përfshin obligimin, shoqëron (përcjell) obligimin e xhihadit: teksti urdhëron që të përgatitet forca me lloje dhe forma të shumta e të ndryshme, ndërsa veçon '*e kuaj të caktuar*' për shkak se ka qenë gjë e njohur dhe në dispozicion për ata të cilëve iu është drejtuar Kur'ani për herë të parë... Ndryshe, sikur t'i urdhëronte për gjëra që ata nuk i njohin, atëherë kjo do të ishte një konfuzion dhe lajthitje, gjëra këto prej të cilave Allahu është i pastër. Islami ka nevojë për një forcë, e cila mëton ta çlirojë njeriun në tokë. Gjëja e parë që bën kjo forcë në fushën e thirrjes islame është: sigurimi i atyre që e përqafojnë këtë kredo dhe garantimi i të drejtës së tyre. E dyta: frikësimi i armiqve, atyre që duan ta sulmojnë Vatrën Islame, e cila është nën protektoratin e kësaj force. E treta: që frika t'i përshkojë armiqtë aq sa ata të mos mendojnë të guxojnë t'i kundërvihen kësaj force, e cila ka marrë rrugën në tërë tokën për ta çliruar njeriun. E katërta: kjo forcë të shkatërrojë çdo forcë e cila i ka dhënë vetes atribute hyjnore për të sunduar njeriun. Pushteti dhe sundimi janë ekskluzivisht vetëm për Allahun. Islami nuk është sistem teologjik, i cili

²⁵ Kutb, Sejjid. *Fi dhilali-l-Kur'an*, f. 3/425; 428; 430.

realizohet me përqendrim në zemër dhe kodifikim ritualesh. Islami është metodë praktike dhe konkrete e jetës. Islami nuk mund të differencohej nga shkatërrimi i atyre fuqive negative, sikurse që nuk është indiferent as ndaj shkatërrimit të ndikimit të këtyre forcave... Muslimani nuk guxon të ndihet i turpëruar nga metodologja e tij hyjnore. Ai nuk ka metodologji njeriu. Ai nuk starton për t'i robëruar njerëzit, me qëllim që klasa borgjeze të sigurojnë fuqinë punëtore, siç ndodhi me romakët, sikurse që nuk vepron as si kapitalizmi që i shfrytëzon tregjet. Islami nuk imponon asnje drejtim dhe ideologji njerëzore, siç ishte rasti me socializmin: ai është vepër e Allahut, të Gjithëditarit, të Urtit, Atij që di çdo gjë në hollësi, Atij që sheh çdo gjë.

Pjesa e ajetit '*E ju përgatituni sa të keni mundësi force*' shpreh një pafundësi mundësish, që nënkupton se asnjeherë nuk duhet kursyer asnje lloj force që mund të përgatitet.

Teksti, po kështu, na tregon për qëllimin kryesor të përgatitjes së forcës ushtarake, e që është: '*...ta frikësoni armikun e All-lahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-lahu i di ata....*'. Pra, qëllimi qenka frikësimi i armiqve të jashtëm, të dukshëm, të shpallur, të deklaruar, dhe atyre që nuk janë të tillë: të fshehtit. Muslimanët janë të obliguar të jenë të fortë dhe të fuqizohen si faktor në tokë, në mënyrë që të tjerët t'ua kenë frikën, që fjala e Allahut të jetë më e larta, që feja t'i takojë vetëm Allahut.

E, meqë përgatitja ushtarake kërkon edhe mund dhe angazhim material, atëherë sistemi islam, i cili është i ngritur mbi bazën e solidarizimit, thirrjen për xhihad e ka sjellë paralel me thirrjen për të shpenzuar pasuri në rrugën e Allahut:




...Çfarëdo që shpenzoni në rrugë të All-lahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë.“ (el-Enfalë, 60)

Ja, kështu Islami e zhvesh xhihadin dhe dhënien (shpenzimin) e pasurisë nga çdo qëllim tjetër individual, nacional apo shtresor qoftë, për ta sjellë ekskluzivisht vetëm për Allahun: “*në rrugë të All-lahut*” që të realizohet - jetësohet fjala e Allahut duke kërkuar gjithnjë kënaqësinë e Tij! Nga këtu, Islami refuzon çdo lloj lufte që ka për bazë mitet e njerëzve, apo që bëhet për të shfrytëzuar të mirat dhe tregjet e vendeve të ndryshme. Po kështu është edhe kundër luftërave që bëhen për të shtypur dhe poshtëruar njerëzit, që bëhen për të caktuar një popull, racë, shtresë të udhëheqë mbi tjetrin/ën; të gjitha këto janë të refuzuara me përjashtim të xhihadit, që është jo në shërbim të caktimit të një populli, race apo individi mbi të tjerët/tjetrin, por që adhurimi për Zotin si dhe ligji dhe sundimi i Tij të janë dominante. Kjo ngase e mira, hairi, bereqeti, liria dhe nderi nuk mund të garantohen ndryshe.”²⁶

Më pas, Profesor Kutubi fillon me shpjegimin e dispozitës së tretë e thotë:

"Dispozita e tretë e nënvizuar në këto tekste ka të bëjë me lidhjen e marrëveshjes dhe paqes me kampin islam. Fjala është për ata që anojnë nga paqja dhe marrëveshja, gjë kjo që vërehet edhe nga veprat dhe sjelljet e tyre.



Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di.” (el-Enfalë, 61)

Shprehja e ‘*animit*’ nga paqja me fjalën ‘*xhunuh*’ (*anon nga diçka me krahë*) flet për butësinë. Është lëvizje e krahut që anon nga paqja dhe lëshon pendlat (puplat) në butësi. Po kështu, urdhri për anim nga paqja është i shoqëruar me tevekkulin – mbështetjen në Allahun, Atë që dëgjon dhe sheh çdo gjë, që di atë që thuhet e flitet përtej të dëgjuarit tonë, Atë që di atë që fshehin zemrat. Dhe mbështetja në Të mjafton dhe sjell sigurinë. Sikur t’i ktheheshim përmbledhjes që Imam Ibnul Kajjimi ka bërë për fraksionet joislame dhe qëndrimet e tyre karshi Muhammedit [paqja dhe

²⁶ Kutb, Sejjid. *Fi dhilali-l-Kur'an*, 3/430-433.

shpëtimi qofshin mbi të!] si dhe qëndrimin e tij ndaj tyre, respektivisht nga koha kur shkoi në Medinë e deri në Ditën e Bedrit dhe kohën kur u shpall kjo dispozitë, është e qartë se ky tekst ka të bëjë për fraksionin (grupin) e atyre që i shmangu i Dërguari i Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] dhe nuk i luftoi, për shkak se ata anuan nga paqja dhe nuk treguan armiqësi dhe rezistencë ndaj Thirrjes Islame dhe as shtetit musliman. Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij që këtë grup, që kishte besë dhe marrëveshje paqeje, ta linte dhe këtë derisa sa zbriti kaptina el-Beraeh (Teube), e cila ftonte që të afatizoheshin për katër muaj grupet që nuk kishin besë (marrëveshje) ose që kishin por të papërcaktuar, në mënyrë që pas kësaj kohe të kishte një dispozitë tjeter, varësisht nga qëndrimi i grupeve në fjalë. Pra, ky vendim nuk ka qenë përfundimtar, sikurse që nuk ka mundur të merret duke anashkaluar elemente të tjera, si p.sh. tekstet e tjera dhe trajtimin e marrëveshjes më pas nga i Dërguari i Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*]. Teksti kishte një lloj përgjithësimi qeverisës në kohën e tij dhe, sipas tij, punoi edhe i Dërguari i Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] deri në kohën kur zbriti kaptina Teube. Produkt i kësaj dispozite ka qenë marrëveshja e Hudejbijes në vitin e gjashtë sipas hixhretit (migrimit).


Disa juristë kanë anuar nga ajo se teksti flet për një aktgjykimi të formës së prerë ndërsa ‘animin nga paqja’ e kanë komentuar me dhënien e xhizjes, por kjo nuk përputhet me realitetin historik. Dispozitat e xhizjes janë shpallur në kaptinën Teube pas vitit të tetë të hixhretit (migrimit), ndërsa ky ajet ka zbritur (është shpallur) në vitin e dytë pas (betejës së) Bedrit, atëherë kur dispozitat e xhizjes nuk ekzistonin fare. Ajo që më së shumti përkon me ngjarjet dhe ndodhitë historike, si dhe me natyrën dinamike të metodologjisë islame, është të thuhet se kjo dispozitë nuk është përfundimtare dhe se ajo ka ndryshuar me shpalljen e dispozitave përfundimtare në kaptinën Teube, ku njerëzve iu jepet njëra nga tri mundësitë:

- 1) Luftues, të cilët e luftojnë Islamin
- 2) Muslimanë, që e kanë pranuar Islamin

3) Ehlu dhimmeh, që jetojnë nën protektoratin islamin dhe e gjëzojnë këtë të drejtë për aq sa ata nuk e prishin atë.

Këto janë dispozitat e fundit tek të cilat përfundon lëvizja e xihadit islamik, ndërsa çdo rast tjetër Islami mundohet ta trajtojë derisa të mbarojë në njërin nga këto tri alternativa, që paraqesin raportet përfundimtare...

Pavarësisht gjërave, ajo që mendojmë ne është se ajeti:



Në qoftë se ata anojnë nga paqja, ano edhe ti nga ajo e mbështetu tek Allahu. Ai është që dëgjon dhe di.” (el-Enfalë, 61)

...nuk përmban dispozitën përfundimtare për këtë kapitull dhe se dispozitat përfundimtare janë shpallur më pas në kaptinën Teube. Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij që të pranonte marrëveshjen me grupin që e kishte shmangur dhe nuk e kishte luftuar, pavarësisht se kishin apo jo besë deri në këtë kohë. Ai vazhdoi të pranonte paqen me jomuslimanët derisa u shpallën këto dispozita në kaptinën Teube. Më pas, mundësitetë ishin vetëm të pranohej Islami ose xhizja, formë kjo e marrëveshjes, jetëgjatësia e të cilës varej nga sjelljet e jomuslimanëve. Apo, nga kjo kuptohej lufta, aq sa muslimanët kanë mundësi për të, në mënyrë që të lartësohet fjala e Allahut të madhëruar dhe feja e Tij. Jam thelluar paksa në këtë pikë për shkak se disa e përjetojnë rëndë këtë kur shkruajnë për 'Xhihadin në Islam' dhe këtë nën presionin e kohës dhe rrëthanave. Ata nuk e njohin fenë e tyre dhe e shohin të tepërt metodologjinë se, në Islam, raportet duhen ndërtuar në njërën prej tri formave:

- 1) Pranim tē Islamit
 - 2) Xhizje, apo
 - 3) Luftë.

Ata i shohin muslimanët si pakicë kundruall shumicës joislame, gjë për të cilën edhe bëjnë këtë interpretim të teksteve, duke mohuar se kjo është metodologjia e Islamit. Ata i qasen teksteve periodike për t'i bërë ato përfundimtare, sikurse që merren me tekste që trajtojnë raste të veçanta

dhe i interpretojnë ato si të përgjithshme, ndërsa kur kanë punë me tekstet përfundimtare, atëherë ato i interpretojnë si periodike. Krejt këtë e bëjnë për të thënë se xhihadi në Islam është vetëm veprim për mbrojtjen e muslimanëve dhe shtetit islam dhe se Islami vrapon pas çdo rasti të lidhjes së marrëveshjes. Marrëveshja nënkupton vetëm braktisjen nga sulmi ndaj Shtetit Islam. Sipas tyre, Islami duhet të izolohet brenda kufijve të vet dhe ai nuk ka të drejtë të kërkojë prej të tjerëve që ta përqafojnë atë e aq më pak të kërkojë t'i nënshtrohen programit hyjnor. Islami nuk ka të drejtë ta sulmojë as forcën materialiste, e cila paraqet injorancën dhe pushtetin e saj mbi njerëzimin, përveç nëse ajo e sulmon. Bile, edhe në këtë rast, do të vepronët vetëm sa për ta mbrojtur veten.

Këta njerëz që kanë pësuar disfatë shpirtërore dhe mendore para presionit dhe trysnisë së realitetit bashkëkohor, sikur të donin të gjenin zgjidhje në dispozitat e fesë së tyre për rrëthanat në fjalë, atëherë këtë realitet dinamik do ta gjenin gjithsesi në dispozitat dhe trajtimet që iu janë bërë periodikisht problemeve me të cilat janë ballafaquar muslimanët dhe të cilat janë të ngjashme me këto me të cilat ballafaqohemi ne sot. Ata do të mund të thoshin: Në raste të këtilla Islami ka vepruar kësisoj dhe kjo nuk është nga rregullat e përhershme, por këto janë vetëm veprime që janë bërë në rrethana në të cilat është dashur të ballafaqohet me gjërat e nevojshme.

Në vijim po paraqesim disa nga shembujt për dispozitat dhe veprimet periodike që merren në kohët e jashtëzakonshme:

- 1) Në fillim të migrimit në Medinë, i Dërguari i Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] lidhi marrëveshje me çifutët dhe jomuslimanët për mbrojtjen e ndërsjellë të Medinës, duke u pajtuar që qendra e pushtetit të jetë i Dërguari i Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*]. Ata duhet t'i ndihmon atij që ta mbronte Medinën nga Kurejshët, me theks të veçantë, dhe nga çdo armik tjetër, sikurse që, pa lejen e tij, ata nuk kishin të drejtë të lidhnin marrëveshje, aleanca etj., me ata që e luftonin Islamin. Në këtë kohë Allahu e urdhëroi të pranonte marrëveshjen e atyre që anonin nga paqja, edhe nëse nuk lidhnin besë me të. Pastaj kjo, siç përmendëm, ndryshoi.

- 2) Në Betejën e Hendekut, kur idhujtarët u bashkuan kundër muslimanëve dhe Benu Kurejdha e prishi marrëveshjen, i Dërguari i Allahut [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*], që kishte frikë për muslimanët, iu ofroi marrëveshje Ujejne ibn Hisn Fezariut dhe Harith ibn Auf Murrit – lider i fisit gatafan, në këmbim të 1/3 të frutave të Medinës, me kusht që ata t'i linin Kurejshët të vetëm. Ky veprim i Muhammedit [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] nuk duhet interpretuar si marrëveshje, për shkak se kur pa se ata u pajtuan, Muhammedi [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] u konsultua me Sa'd ibn Muadhin dhe Sa'b ibn Ubaden, të cilët i thanë: "O i Dërguari i Allahut, a është kjo diç që po do që ne ta bëjmë për ty, apo është urdhër i Allahut të cilin duhet ta dëgjojmë dhe respektojmë, apo është punë që ti po dëshiron ta bësh për ne?" "Jo, është punë që unë dua ta bëj për ju, ngase arabët iu janë vërsulur juve si të bashkuar' - iu përgjigj. "O i Dërguari i Alalhut! Ne dhe ata ishim idhujtarë që nuk e adhuronim dhe nuk e njihnim Allahun, dhe përkundër kësaj ata kurrë nuk kanë lakuar (nuk kanë pasur guximin të shikojnë) në pasuritë tona dhe nuk kanë menduar t'i realizojnë ndryshe vetëm se duke i blerë ose me mikpritje, e tash që kemi pranuar Islamin dhe jemi nderuar nga Allahu me të, a mendon t'ua japim pasuritë tona?! Pasha Allahun, nuk iu japim tjetër vetëm se shpatën, derisa Allahu të gjykojë në mes nesh!" Pejgamberi [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] u gëzua shumë dhe tha: "Ju dhe ajo!" Ndërsa atyre idhujtarëve iu tha: "Shkon se me ju nuk kemi tjetër vetëm se shpatën!" Kjo që Muhammedi [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] mendoi ishte veprim për rrëthana të jashtëzakonshme dhe nuk ishte ndonjë vendim përfundimtar.
- 3) Pejgamberi [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të!*] lidhi marrëveshjen e Hudejbijes me idhujtarët me kushte, të cilat ishin të papranuara për muslimanët. Respektivisht, kishte ndaluar luftën - kishte lidhur armëpushim për dhjetë vite. Marrëveshja parashihte që muslimanët të mos e kryen në Haxhin atë vit, po këtë ta bënë vitin e ardhshëm ku do të qëndronin në Mekë tri ditë, ndërsa shpatat do t'i kishin në këllëf. Marrëveshja parashihte që në rast se dikush prej jomuslimanëve i bashkëngjitej muslimanëve duhet të kthehej, ndërsa

e kundërta nuk parashihej. Pejgamberi [*paqja dhe shpëtimi qofshin mbi tē!*] u pajtua me këto kushte për shkak se ato, edhe pse dukeshin sipërfaqësisht të padrejta, ishin bërë me frymëzim nga Allahu. Ato, pavarësisht rrethanave, kanë hapësirë për t'u ballafaquar me rrethanat e ngjashme në të cilën (hapësirë) vepron lidershipi musliman...”²⁷

²⁷ Kutb, Sejjid. *Fi dhilali-l-Kur'an.* 3/430-438.

Përfundim

Në përfundim të këtij referimi do të doja të shpreh falënderimet e mia më të sinqerta për Allahun e Madhëruar, pa ndihmën e të Cilit nuk do të mund të arrija gjer këtu, sidomos në këtë kohë me aktivitete kaq të ngjeshura; vetëm brenda tri javëve mora pjesë në tri konferenca të ndryshme, andaj e falënderoj shumë Allahun dhe e lus që këtë angazhim të ma deponojë në botën tjetër, atëherë kur do të kemi më së shumti nevojë për ndihmën dhe mirësitë e Tij!

Padyshim, për punime të rëndësishme sikur ky, studuesi duhet t'iu referohet librave të shumta të Tefsirit, në mënyrë që të arrijë në një rezultat të kënaqshëm shkencor dhe, po kështu, me qëndrim të qartë. Komentuesit klasikë dhe këta bashkëkohorë janë pajtuar se '*forca*' (ar. القوّة), e përmendur në hadith, komentohej si '*remj'* (ar. الرَّمْي - gjuajtje, hedhje), sikurse që në kuadër të domethënies dhe botëkuptimit të '*remj*'-it kanë futur edhe zbulimet teknologjike ushtarake dhe armët e sofistikuara.

Gjatë punimit patëm rastin të mësojmë se ata që ndajnë mendimin e anulimit [abrogimit] (ar. *nes'h*) të ajetit të marrëveshjes (si dispozitiv) janë një grup i vogël, ndërsa shumica absolute mendon se marrëveshja është akt legjitim, pavarësisht se palët armike janë apo nuk janë të sinqerta në marrëveshjen e tyre. Neve na mjafton Allahu!

Ai që ka dhënë detaje më të shumta rrëth kësaj çështjeje është Sejjid Kutubi, i cili mendon se dispozitat që parashtrojnë ajetet nga kaptina el-Enfalë kanë qenë në shërbim periodik të legjisacionit, pra kanë qenë valide për një kohë dhe nuk kanë qenë të përhershme. Ky është mendim personal i tij dhe përpjekje e rezultat pas analizave shkencore. Ai mendon se dispozitat përfundimtare për këtë çështje janë në kaptinën et-Teube. Mbështetje për mendimin e vet ka konstatimin e Ibnu-l-Kajjimit përkitazi me grupet e njerëzve dhe qëndrimet e tyre karshi Daves Islame (fesë islame) që nga shpallja. Kutubi mendon se Islami ka ardhur për t'i çliruar njerëzit nga despotët e kësaj bote dhe se ai nuk pranon që një racë apo shtresë ta nënshtrojë tjetrën. Asaj, që i duhet nënshtruar, sqaron ai, është

Fjala e Allahut, gjë e cila nuk mund të arrihet pa mposhtur tiranët dhe zullumqarët.

Thënë të drejtën, personalisht nuk pajtohem me atë se dispozitat e sipërpërmendura kanë qenë të përkohshme. Të paktën mua nuk më ka rënë të lexoj për diç të tillë dhe as që kam mundur të kuptoj një gjë të tillë nga tekstet fetare dhe, përderisa nuk ka ndonjë tekst abrogues, atëherë tekstet dhe qëndrimet kuptohen dhe interpretohen si të përgjithshme, dhe kjo në përputhje me rregullin: “*Mësimi merret nga gjithëpërfshirja e tekstit, jo nga veçantia e shkakut.*” Po kështu, sunneti praktik (es-sunnetu el-fi’lijeh) është argument pér ne, sikurse që as vetë Sejjid Kutubi nuk thotë në formë deklarative se është abroguar. E tëra që thotë ai është se marrëveshja me armiqtë është një nga ato qëndrime që kanë qenë të përkohshme dhe periodike, konstatim ky që provokon pyetje, si:

Çfarë të bëjmë me rastet në të cilat Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka lidhur marrëveshje me armiqtë, e të cilat janë vërtetuar me tekste, mësimet e të cilave ne e kemi obligim t’i përvetësojmë? Ne, bazuar në tekstet kur'anore dhe pejgamberike, jemi të urdhëruar që, sa herë të jepet shansi dhe mundësia pér armëpushim dhe marrëveshje me armiqtë, ta bëjmë një gjë të tillë, duke mos qenë këto asnëjëherë në kurriz të fesë. Nëse Kryetari sheh se armëpushimi është në dobi të muslimanëve, atëherë kemi leje ta bëjmë, ngase nuk kemi ardhur pér të jetuar përgjithmonë nën hijen e shpatave, nën breshëritë e automatikëve, nën ankthin e bombave. Xhihadi, siç përmend Kur’ani, është ligësuar. Ndonëse është një gjë që nuk e duan njerëzit (jeta është e dhimbshme), ai, në fakt, hyn në veprim vetëm atëherë kur është i domosdoshëm dhe kur nderi dhe autoriteti i besimtarëve cenohet. Po kështu, ajo që nuk duhet harruar këtu është se ai që mund të marrë vendimet përkatëse është prijësi legjitim, ndryshe, nuk mund t’ua hapim këtë derë personave, individëve apo grupeve të vogla që ta ngrenë flamurin e xhihadit. Zoti e di më së miri!

Bibliografi:

1. El-Xhezairi, Ebu Bekr AbduRahman. *Ejserut tefasir*, Darul beshair, b.2, Xhidde, Saudi.
2. Err-Razi, el-Fahr, *Mefatihul gajb*, b.2, 1985.
3. *Sahihu Muslim bi sherhil Imami-n-Nevevijj*, b.2, Darul kutub el-ilmiyeh, Bejrut, 2001.
4. Taberi, Muhammed b. Xherir, *Xhamiul bejan an te'vili aji-l-Kur'an*, Darul mearif, Kajro, b.1, 1990.
5. Tantavi, Sejjid, *Tefsirul vesit*, Darul melajin, Bejrut, b.2, 2000.
6. Kurtubi, Ebu Abdullah, *el-Xhamiu li ahkamil Kur'an*, Darul kutub el-misrijeh, b.1, 1987.
7. Kutb, Sejjid, *Fi dhilalil Kur'an*, Darush shuruk, Bejrut, b.2, 1992.